



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E HARTIMIT TË PROJEKTEVE DHE KONTROLLIT TË PUNËVE PUBLIKE

Nr. 995 Prot.

Fier me. 10.07.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 68, datë 10.07.2026

“Për miratimin e projektit: “Rikonstruksion i rruges Aulona, nga rrethrotullimi i QTU^{se} deri tek kthesa e Azotikut.

Të nderuar këshilltarë,

Projekt-Vendimi “Për miratimin e projektit “Rikonstruksion i rruges Aulona, nga rrethrotullimi i QTU^{se} deri tek kthesa e Azotikut, është përgatitur në mbështetje të:

- Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Per Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar);
- Ligj Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
- Vendimit të Këshillit të Bashkisë Fier Nr. 118, dt 11.12..2025 «Për miratimin e Programit buxhetor afatmesëm (PBA) 2026-2028 përfundimtar dhe miratimin e buxhet të vitit 2026 ;

PROPOZOJMË:

1. Miratimin e projektit: “Rikonstruksion i rruges Aulona, nga rrethrotullimi i QTU^{se} deri tek kthesa e Azotikut.
2. Ngarkohet ekzekutivi i Bashkisë Fier për zbatimin e këtij vendimi.

**Drejtoria e Hartimit te Projekteve dhe
Kontrollit te Puneve Publike**
Silvana Basha

**Drejtoria e Financë, Buxhetit dhe
Kontabilitetit**
Pranvera Çina

Drejtoria Juridike
Esmeralda Kapllanaj

Miratoi:
Zv/Kryetar
Mariglen Hoxha

KRYETARI
Armando Subashi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E HARTIMIT TË PROJEKTEVE DHE KONTROLLIT TË PUNËVE PUBLIKE

Nr. 9095/1 Prot.

Fier me. 10 27.2026

RELACION

“Për miratimin e projektit: “Rikonstruksion i rruges Aulona, nga rrethrrrotullimi i QTU^{se} deri tek kthesa e Azotikut.

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Per Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligj Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Bashkisë Fier Nr. 118, dt 11.12..2025 «Për miratimin e Programit buxhetor afatmesëm (PBA) 2026-2028 përfundimtar dhe miratimin e buxhet të vitit 2026, propozojmë miratimin e projektit: “Rikonstruksion i rruges Aulona, nga rrethrrrotullimi i QTU^{se} deri tek kthesa e Azotikut.

Rruga “AULONA”, FIER është pjesë kryesore kompozicionale e zhvillimit radial të sistemit rrugor të qytetit të Fierit. Është vazhdimi i rruges “Ramiz Aranitasi”. Rruga e marrë në studim ka një gjatësi në vijë lineare 930 ml. Rruga “ AULONA” ndodhet në lagjen “Kryengritja e Fierit”, rruga shtrihet nga perfundimi i rruges “ Ramiz Aranitasi” deri te kthesa e “Azotik”.

Koncepti i ndërhyrjes lidhet ngushtë me rrugën dhe tenton të japë alternative për të përfituar më tepër hapësirë. Rikonceptimi bëhet me qëllim kthimin e kësaj zone në një zonë me karakter social-kulturor, përmirësimit të dimensioneve të rrugës, të strukturës dhe të infrastrukturës, në përputhje me standartet bashkëkohore. Synohet të krijohet një hyrje kryesore për në qytet me standarte bashkëkohore. Me këtë ndërhyrje do të lirohet qarkullimi i automjeteve gjatë hyrjes dhe daljes për në qytet si dhe lehtësimi i levizjes së bicikletave dhe levizjes së kembësoreve.

Struktura e rruges do të jete e tille:

- Nga QTU deri te shinat e trenit rruga ka gjatësinë 745m dhe do të jete me katër korsi. Dy korsi për të dalë nga qyteti dhe dy korsi për të hyrë në qytet. Në anën perendimore rruga do të ketë një korsi parkimi për automjetet. Rruga do të trajtohet e ndarë në mes me një trafik ndarës me ngjeresi 1m. Gjeresi e trupit të rruges në këtë segment do të jete 18m (8.5+1+8.5). Në këtë segment rruga do të trajtohet me trotuare dhe korsi e dedikuar për bicikletat në të dyja anët e saj. Trotuari do të ketë gjatësinë 3m anën lindore dhe në perendimore të rruges.

-Nga shinat e trenit deri te kthesa e “Azotik” rruga ka gjatësinë 185m dhe do të jete me katër korsi. Dy korsi për të dalë nga qyteti dhe dy korsi për të hyrë në qytet. Gjeresi e trupit të rruges në këtë segment do të jete 14.4m (7.2+7.2). Në këtë segment rruga do të trajtohet me trotuare dhe korsi e dedikuar për bicikletat në të dyja anët e saj. Trotuari do të ketë gjatësinë 3m anën lindore dhe në perendimore të rruges.

-Ne te gjithë gjatesine e saj rruga do te trajtohet me ndricim te larte me dy koka ne pjesen e trafikndaresit dhe me ndricim te ulet per trotualet ne te dyja krahet e saj.

-Rruga ne te gjithë gjatesine e saj, ne te dyja anet do te trajtohet me peme dekorative, ndersa tek trafikndaresei do te mbillen shkurre dekorative te uleta.

Fondi total i ketij investimi perllogaritet ne vleren 240 300 976.44 leke.

**Drejtoria e Hartimit te Projekteve dhe
Kontrollit te Puneve Publike**
Silvana Basha

**Drejtoria e Financë, Buxhetit dhe
Kontabilitetit**
Pranvera Çina

Drejtoria e Planifikimit te Territorit
Florjan Troka

Miratoi:
Zv/Kryetar
Mariglen Hoxha

KRYETARI
Armando Subashi

